

Sporti Shkollor në Fushë Kosovë mbajti garat regjionale në ping pong

Dje, Sporti Shkollor në Fushë Kosovë mbajti garat regjionale në ping pong, të cilat i përkrahi edhe Drejtoria Komunale për Arsim - Fushë Kosovë. Në këto gara ishte i pranishëm edhe drejtori i Arsimit, Z.Samir Shahini, i cili bëri hapjen e këtyre garave. Ai me këtë rast iu drejtua nxënësve me një fjalë rasti, dhe u shprehi mbështetjen e plotë dhe të pa kursyer të drejtorisë që e udhëheqë, njëherit u dëshiroi fat dhe suksese të gjithë garuesve.

Shoqatën e Sportit Shkollor në Fushë Kosovë e përfaqësuan Gjimnazi “Hivzi Sylejmani” në dy kategoritë, kurse ShFMU u përfaqësuan nga ShFMU “Selman Riza” të djemtë dhe u rangun në vendin e dytë, kurse tek vajzat u përfaqësua nga ShFMU “ Vëllezërit Frashëri” dhe u rangun në vendin e dytë.